



Për: Mediat e shkruara dhe elektronike
Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim
Subjekti: Behgjet Pacolli shpallet qytetar nderi në Kazakistan

Prishtinë, 12 dhjetor 2007

Behgjet Pacolli shpallet qytetar nderi në Kazakistan



Me rastin e 10 vjetorit të kryeqytetit të ri të Kazakistanit, Astana, Parlamenti i këtij shteti, me propozimin e presidentit Nursultan Nazerbajev, e dekoroi kryetarin e Aleancës Kosova e Re, njëkohësisht udhëheqësin e “Mabetex Group”, Behgjet Pacolli, me dekoratën më të lartë shtetërore “Qytetar nderi”. Prej formimit të këtij shteti e deri tani, me këtë dekoratë janë shpërblyer 17 personalitete.

Kjo dekoratë i jepet Behgjet Pacollit për kontributin që i dha këtij shteti dhe zhvillimin

ekonomik të saj, e pikërisht ndërtimin e kryeqytetit Astana.

Sipas vendimit të Parlamentit të Kazakistanit të vitit 1994, dekretohet ngritja e kryeqytetit të ri Astana në një fushë të gjelbër, dhe vetëm pas 10 vjetëve nga fillimi i ndërtimit e deri tani, ky qytet i ka mbi 700 mijë banorë. Ndërrimi i kryeqytetit nga Almaty i lashtë në jug, në Astana në veri të Kazakistanit u bë për shkaqe politike - për shkak të rrezikut për ndarje të pjesës veriore të shtetit, pasi atje dominonte nacionaliteti rus dhe nga Moska, pas pavarësimit të Kazakistanit, vinin zëra kërcënues. Situatë analoge si veriu i Mitrovicës, por atje në përmasa më të mëdha.

Të hënën, më 10 dhjetor, Kazakistani i festoi të arriturat në demokratizimin e jetën politike dhe përparimet në sferën ekonomike.

Në vitin 2010, Kazakistani do të ketë udhëheqësinë e OSCE-së.